

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
" INFINITY DESIGN " sh.p.k

Sot, më datë 08.09.2025 (dymijë e njëzetë e pesë), nga Ortaket Themelues:

1. **Hasan Golve** i biri i Ilyas-it, lindur me 27.05.1998, ne Beyoglu, Turqi, me banim **Rr. "Ismail Qemali"**, Pall Samos Tower, Kt. 5, Ap. 27, Tiranë, i pajisur me pasaporte me nr. personal 10064536476 madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
2. **Gorkem Aksu** i biri i Kadir-it, lindur me 14.05.1998, ne Fatih, Turqi, me banim **Rr. "Ismail Qemali"**, Pall Samos Tower, Kt. 5, Ap. 27, Tiranë, i pajisur me pasaporte me nr. personal 38099185216 madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Madhorë dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar vendosi themelimin e shoqërisë tregtare **" INFINITY DESIGN " sh.p.k** sipas termave të mëposhtme.

Neni 1

Shoqëria **" INFINITY DESIGN " sh.p.k** formohet si shoqëri tregtare dhe rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria do të dale ne qarkullimin juridiko-civil me emrin **" INFINITY DESIGN " sh.p.k**

Neni 3

Selia e Shoqërisë

Zyra qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën: **Rr. "Ismail Qemali"**, **Pall Samos Tower, Kt. 5, Ap. 27, Tiranë.**

Me vendim të Asamblesë se Ortakeve kjo zyrë e shoqërisë mund të ndryshohet, të hapen filiale dhe përfaqësi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë por jo të kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

1. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar me ligj në Republikën e Shqipërisë; veprimtari në fushën dizenjimit grafik, dizenjimit editorial, dizenjimit të



markave dhe amablazhimeve, dizenjimit në sektorin e prodhimit të reklamave si (logo, video, tipografi ose logotip) brenda dhe jashtë vendit.

2. Shoqëria do të realizoj: Tregtimin import-eksportin me shumice e pakice, te te gjitha mallrave me ose pa akcize, blerjen dhe dhenien me qera te automjeteve te ndryshme.
3. Objekti i shoqërisë mund të plotësohet e modifikohet në çdo kohë me miratimin e Asamblesë se Ortakëve në përputhje me ligjet në fuqi. Shoqëria mund të marrë pjese ne shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të.

Neni 5 **Kapitali Themeltar i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000, (njëqind mije) Lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

Nr	Emri, Mbiemri/ Person Fizik/Juridik	% që disponon	Kuotat që disponon
1	Hasan Golve	50 %	1
2	Gorkem Aksu	50 %	1

Kapitali themeltar është investuar në total nga pasuria e ortakut themelues.

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota. Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi te marrin miratimin e ortakëve te tjerë te shoqërisë, duke respektuar te drejtën e parablerjes, kur transferimi behet me anë te shitjes.

Neni 6 **Kohëzgjatja**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor te pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 7

Organet Drejtuese

Bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit Shqiptar në fuqi, organet drejtuese të shoqërisë "INFINITY DESIGN" sh.p.k janë si më poshtë vijon;

1. **Asambleja e përgjithshme e Ortakeve** – është organi më i lartë vendimmarrës.
2. **Administratori** – është organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e funksionimit dhe e organizimit të tyre është e përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

1. Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Hasan Golve** i biri i Ilyas-it, lindur me 27.05.1998, në Beyoglu, Turqi, me banim Rr. "Ismail Qemali", Pall Samos Tower, Kt. 5, Ap. 27, Tiranë, i pajisur me pasaportë me nr. personal 10064536476 madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretet nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me statutin e shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Shoqëria do të emërojë ekspertet kontabël. Ekspertet kontabël të autorizuar të shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi, për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 9

Ortaku themelues të shoqërisë mund të vendosë me vullnetin e tyre të lirë e të plote të tyre, për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tregtarë privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara në ligj.

Neni 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, hapja e degëve dhe filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit në fuqi.

Neni 11

Ortaku i Shoqërisë duhet të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë. Te punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe

detyrohen te zhdëmtojnë shoqërinë për demet qe i janë shkaktuar për faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarisë se tyre.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet qe mund te lindin midis ortakeve apo midis ortakeve dhe shoqërisë, te cilët mund te kenë si objekt te drejta si rrjedhim i raporteve te tyre me shoqërinë do te zgjidhen nga Gjykata e Juridiksionit te Përgjithshëm Tirane.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze te ligjit, një kopje për t'u dorëzuar ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe dy kopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Me date 15.07.2025, ne Tirane, ky statut u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lire e te plote te Ortakut themelues qe përfaqësojnë totalin e kuotave te kapitali themeltar, nga ortaku Caner Pomak ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, te ndryshuar dhe Nenin 43 te Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" ne 3 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njëjtë ligjore.

ORTAKET E SHOQERISE

Ortaku

Hasan Golve

Ortaku

Gorkem Aksu

Perfaqesuar me prokure nga ;

Av. Korab Cani

Korab Cani

